

VENDIM
Nr. 93, datë 28.7.2015

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC KABASH POROCAN” SHPK NË
AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC – ET
“HOLTA KABASH” DHE “HOLTA POROCAN” ME FUQI TË INSTALUAR
PËRKATËSISHT 2.2 MË DHE 3.3 MW, (ME FUQI TOTALE 5.5 MW)**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37 germa “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5 pika 1, germa “a”, 13 dhe 14 pika 1 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.7.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Kabash Porocan” sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

1. Shoqëria “HEC Kabash – Porocan” sh.p.k. ka aplikuar për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike në datën 13.5.2015 në zbatim të ligjit nr. 9072, datë 23.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 76, datë 8.6.2015, miratoi fillimin e procedurave për prodhimin e energjisë të shoqërisë “HEC Kabash – Porocan” sh.p.k.

2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer në zbatim të nenit 16 të ligjit nr. 9072, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

3. Në datën 15.5.2015 ka hyrë në fuqi ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”.

4. Në ligjin nr. 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që ligji nr. 9072 datë 22.5.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, shfuqizohet.

5. Në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110 pika 2 të tij parashikohet se: Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.

Për sa më sipër dhe duke qenë se aplikimi i shoqërisë “HEC Kabash Porocan” sh.p.k, plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, 4.1.4, 4.1.5) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “HEC Kabash Porocan” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Holta Kabash” me fuqi të instaluar 2.2 MW dhe “Holta Porocan” me fuqi të instaluar 3.3 MW, (me fuqi totale të instaluar 5.5 MW), për një afat 30 – vjeçar.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti